



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

05 Nr. 06-24507/23

Klinë, datë: 26.07.2023

PROCESVERBAL

Nga Debati me Publikun në fshatin Zajm, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët "MOTRAT QIRIAZI", bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Deiq, Paskalicë dhe Polce. Tubimi u mbajt me datë 16 qershor 2023 dhe filloi në orën 18:30, ku morën pjesë: 11 persona.

RENDI I DITES

1. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e mori drejtori i drejtorisë së Financave ka bërë një prezantim në pika të shkurtra projektet e planifikuara infrastrukturore në këto zona e lartcekura.

Kryetari Elezaj gjatë hapjes së këtij takim para të pranishmëve, me një fjalë rasti informoi për euro investime të reja të cilat do të implementohen në projekte brenda këtij viti e që kontrata tashmë është nënshkruar 264 mijë euro për Zajm- Deiq, për asfaltimin e rrugëve, ndërsa nëpër Polce do të kalojë projekti i asfaltimit të rrugëve lokale si dhe ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të cilit po ashtu i është finalizuar kontrata. Ai gjithashtu theksoi se si institucion mbesim të përkushtuar në orientimin e fondeve për të investuar në shtretërit e lumenjve pasi kjo zonë çdo herë përballlet me vërshime.

Pas kryetarit të komunës, fjala ju dha të pranishmëve, banorëve nga Zajmi, Deiqi, Polc dhe Paskalica.

DISKUTIMET DHE KËRKESAT

Metë Krasniqi – Fshati Zajm, kërkon shtrirje të kanalizimit tek lagjja "Ferat Thaqi".

Tunë Dedaj - Fshati Deiq, kërkon rritje të investimeve te këto lokalitete dhe ndarje me të mëdha buxhetore për këto zona e po ashtu shpreh preokupimin për vërshimet, pasi që këto zona janë të prekura nga vërshimet dhe dëmet e mëdha qe po ju shkaktohen banorëve.




Gjatë debatit me publikun, lidhur me Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, i cili u mbajt Zajm, në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët “MOTRAT QIRIAZI”, bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Deiq, Paskalicë dhe Polce, morën pjesë: 11 persona.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	0
Meshkuj	11
Total:	11

Takimi përfundoi në orën 18:22.

Procesmbajtësi:
Nikson Daka


Klinë, datë:

